



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë), nenit 40 paragrafi 2 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas lëndës së formuar pas një denoncimi të dorëzuar nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK), në vazhdimin e seancës së tij të 84-të të mbajtur më 31.03.2023, vendosi si më poshtë:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-7369/1 të vitit 2022, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja ka vepruar tashmë sipas të dhënave të subjektit, sipas çështjes me numër 12-2273 të vitit 2020, për të cilën në seancën e 67-të të mbajtur më 13.05.2022 ka marrë vendim nr. 12-219/6 të datës 20.05.2022, i cili në formë të depersonalizuar është publikuar në faqen e saj të internetit.

Lënda me numër 12-7884 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numrin 12-7369/1 e datës 27.07.2022 është formuar në bazë të një ankese të paraqitur nga ///. Argumentet e paraqitura kanë të bëjnë me dyshimet për kryerjen e pavetëdijshme të funksionit të inspektimit nga kreu i sektorit të urbanizmit në ///, duke shkaktuar dëme ndaj parashtruesit. Nga KSHPK-ja kërkohet të shqyrtojë çështjen në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Nuk është dhënë asnjë provë në mbështetje të ankesës.

Pas shikimit në përmbajtjen së denoncimit, KSHPK-ja ka përcaktuar se sipas të dhënave në fjalë tashmë ka vepruar për çështjen me numrin 12-2273 të vitit 2020, për të cilën në seancën e 67-të të mbajtur më 13.05.2022 ka marrë vendimin nr. 12-219/6 të datës 20.05.2022, i cili në formë të depersonalizuar është publikuar publikisht në faqen e saj të internetit.

Në pajtim me sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar :
- parashtruesi.

Përpiloi: Mr. D.D
Miratoi: Mr. G.T

**КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
НЁНКРЬЕТАР,
Katica Nikolovska**

